



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 1631/Prot.

Pogradec, më 30 . 04 . 2025

VENDIM

Nr. 37 ,Datë 28 . 04 2025

PËR

“MIRATIM TË IMPLEMENTIMIT NË RAST APROVIMI TË PROJEKTIT ME TITULL “SISTEM INFORMATIV PARALAJMËRUES PËR MBIKËQYRJEN HIDROMETEOROLOGJIKE TOKË-UJË.”NË KUADËR TË PROGRAMIT NDËRKUFITAR, INTERREG (VI-A) IPA CBC “GREQI-SHQIPËRI 2021-2027”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pika 2, nenit 9, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 28, pika 1, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, “, të Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr.450 datë 26.07.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritimit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore” pika 1 dhe 2 gërma (b) dhe (d) Koordinimi i programeve të asistencës së Bashkimit Evropian në nivel vendor dhe projekteve ku përfiton Bashkia, në lidhje me aplikimin në projektin me titull **“SISTEM INFORMATIV PARALAJMËRUES PËR MBIKËQYRJEN HIDRO-METEOROLOGJIKE-TOKË-UJË”**, në kuadër të Programit Ndërkufitar Greqi-Republika e Shqipërisë nën Instrumentin e Asistencës së Paraantarësimit INTERREG (VI-A) IPA CBC “GREQI-SHQIPËRI 2021-2027” me propozim të Kryetarit të Bashkisë Pogradec, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1.Të miratojë implementimin në rast aprovimi të projektit me titull **“SISTEM INFORMATIV PARALAJMËRUES PËR MBIKËQYRJEN HIDRO-METEOROLOGJIKE-TOKË-UJË”** të financuar nga Programi Ndërkufitar Greqi - Shqipëri **2021-2027**

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com



2.Bashkia Pogradec,si partner në këtë projekt,bazuar në kushtet dhe kriteret e aplikimit në projekte IPA,në rastin e miratimit të projektit nga vlerësuesit e Delegacioni Evropian,të marrë përsipër mbulimin e kostos së bashkëfinancimit të projektit dhe TVSH-së bazuar në buxhetin e palës shqiptare dhe përfshirjen e kësaj kostoje dhe TVSH-së në buxhet.

3.Për zbatim të këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë Pogradec, Njësia e Integritetit Evropian dhe administrata e Bashkisë Pogradec të ndjekë të gjitha hapat e duhura për ecurinë e projektit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

1.Miratuar me 18 vota

2.Vota Pro 18

3.Vota Kundër 1

4.Vota Abstenim 1

5.Zbardhur më date 30.04.2025

